

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PRANIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KRYEMINISTRI EDI RAMA, NË KARTËN E BORDIT TË PAQES”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes. Këshilli i Ministrave me vendimin nr.45 , datë 21.1.2026, ka miratuar, në parim, marrëveshjen.

Marrëveshja synon krijimin e Bordit të Paqes si një organizatë ndërkombëtare, me personalitet ligjor ndërkombëtar, me qëllim promovimin e stabilitetit, rivendosjen e një qeverisjeje të besueshme e të ligjshme, si dhe sigurimin e paqes së qëndrueshme në zonat e prekura ose të kërcënuara nga konflikti. Bordi i Paqes do të ndërmarrë funksione të tilla të ndërtimit të paqes në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në përputhje me këtë Kartë, duke përfshirë zhvillimin dhe përhapjen e praktikave më të mira të mundshme për t’u zbatuar nga të gjitha shtetet dhe komunitetet që kërkojnë paqe.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është në përputhje me programin politik të qeverisë shqiptare që lidhet me qëndrimin e Republikës së Shqipërisë ndaj çështjeve të paqes, sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Bordin e Paqes përbën një zhvillim me rëndësi të veçantë për politikën e jashtme dhe diplomacinë e vendit. Ky angazhim është një njohje e drejtpërdrejtë ndërkombëtare për rolin konstruktiv, të besueshëm dhe të përgjegjshëm që Shqipëria ka ndërtuar ndër vite në fushën e paqes, sigurisë dhe stabilitetit global.

Statusi i anëtarit themelues i jep Shqipërisë një rol aktiv dhe të barabartë në formësimin e vizionit, parimeve dhe arkitekturës vendimmarrëse të këtij mekanizmi ndërkombëtar. Ky status rrit ndjeshëm profilin dhe vizibilitetin e vendit në skenën globale, duke e pozicionuar si faktor stabiliteti dhe aktor paqeje në një proces që synon t'i japë fund një konflikti shumëdekadash në Lindjen e Mesme.

Ky zhvillim është gjithashtu një konfirmim i partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili mbetet boshti kryesor i politikës së jashtme shqiptare dhe garancia e orientimit euroatlantik të vendit. Shqipëria vlerësohet si një aleate e besueshme, e parashikueshme dhe e përkushtuar ndaj vlerave të përbashkëta të paqes, sigurisë dhe rendit ndërkombëtar, të bazuar në rregulla.

Pjesëmarrja në Bordin e Paqes është një angazhim si një kontribut real në ndërtimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke u udhëhequr nga interesi kombëtar, nga përgjegjësia ndërkombëtare dhe nga respekti për të drejtën ndërkombëtare.

Shqipëria me këtë pjesëmarrje tregon se është një vend që nuk konsumon, por prodhon dhe eksporton stabilitet. Ky perceptim është rezultat i një politike të jashtme koherente, të përgjegjshme dhe të ndërtuar mbi respektimin e angazhimeve ndërkombëtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenet 78, 81, pika 1, 83, pikat 1 dhe 2, dhe 121, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, të Kushtetutës, si dhe me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.45 , datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave.

Duke qenë se pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Bordin e Paqes përbën një zhvillim me rëndësi të veçantë për politikën e jashtme dhe diplomacinë e vendit, kërkesa për miratimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar bëhet në përputhje me parashikimin e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së pranimit të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes, sipas tekstit bashkëlidhur. Karta përbëhet nga 13 krerë që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e tij, konkretisht si vijon:

Kreu I parashikon krijimin e Bordit të Paqes si një organizatë ndërkombëtare, me misionin për të ushtruar funksione të ndërtimit të paqes, stabilitetit dhe rindërtimit në territore të prekura nga konflikti, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe dispozitat e Kartës së tij themeluese.

Kreu II parashikon anëtarësimin në Bord nga shtetet anëtare, në bazë të ftesës nga kryetari dhe njoftimit formal të pëlqimit për të qenë të lidhur nga kjo Kartë, sipas parashikimeve të nenit 11 të Kartës. Shtetet mund të përfaqësohen në Bord nga Kreu i shtetit ose Kreu i qeverisë.

Karta garanton ruajtjen e sovranitetit të shteteve anëtare, duke parashikuar se asnjë dispozitë e saj nuk i jep Bordit juridiksion brenda territorit të një shteti anëtar dhe as nuk e detyron një shtet anëtar të marrë pjesë në një mision specifik ndërtimi paqeje pa pëlqimin e shprehur të shtetit.

Çdo shtet anëtar ka një mandat trevjeçar nga data e hyrjes në fuqi të Kartës, subjekt i rinovimit nga Kryetari i Bordit të Paqes. Ky afat trevjeçar nuk zbatohet për shtetet anëtare, të cilat kontribuojnë më shumë se një miliard dollarë amerikanë (1 000 000 000 USD) në fonde monetare (“*cash*”) brenda vitit të parë nga hyrja në fuqi e Kartës.

Anëtarësimi përfundon në rastin më të hershëm me: (i) përfundimin e një mandati trevjeçar, sipas nenit 2.2 (c) dhe rinovimit nga Kryetari; (ii) tërheqjen, sipas nenit 2.4; (iii) një vendim nga Kryetari, ose (iv) shpërbërjen e Bordit të Paqes në përputhje me kreun X. Megjithatë, një shtet i tillë mund të ftohet përsëri të bëhet shtet anëtar.

Krerët III dhe IV parashikojnë strukturën e qeverisjes së Bordit, që drejtohet nga kryetari, dhe ushtron funksione vendimmarrëse përmes Bordit të Shteteve Anëtare dhe Bordit Ekzekutiv. Vendimet merren me shumicë votash, por kërkojnë konfirmimin e Kryetarit, i cili gëzon gjithashtu të drejtën e vetos dhe autoritetin përfundimtar interpretues.

Kreu V parashikon dispozita financiare, sipas të cilave Bordi do të financohet nëpërmjet kontributeve vjetore vullnetare të vendeve anëtare. Gjithashtu, do të krijohen llogari për përmbushjen e këtij misioni.

Kreu VI parashikon se Bordi dhe strukturat e tij gëzojnë personalitet ligjor ndërkombëtar, duke e pajisur atë me kapacitetet e nevojshme për të përmbushur misionin e tij. Bordi i Paqes dhe personeli i tij të gëzojnë privilegje dhe imunitete të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre, të cilat do të përcaktohen përmes marrëveshjeve me shtetet pritëse ose përmes masave të tjera në përputhje me legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve.

Krerët VII deri në XVIII parashikojnë dispozitat përfundimtare të Kartës, konkretisht në lidhje me:

1. zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore;
2. ndryshimin e Kartës;
3. tagrin e Kryetarit për të miratuar rezoluta apo direktiva në emër të Bordit, për zbatimin e misionit të tij;
4. kohëzgjatjen për një periudhë të pacaktuar;
5. përfundimin;
6. mënyrën e hyrjes në fuqi të Kartës dhe zbatimin e përkohshëm, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shteteve;
7. depozitarin, roli i të cilit do të kryhet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
8. rezervat, të cilat nuk lejohet të bëhen nga shtetet anëtare;
9. gjuhën zyrtare, që do të jetë anglishtja;
10. selinë e Bordit dhe strukturave të tij, që do të përcaktohet në marrëveshje me shtetin pritës, sipas nevojës;
11. vulën, që do të miratohet nga Kryetari i bordit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Për zbatimin e marrëveshjes ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në bazë të informacionit të përcjellë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Uashington.

Marrëveshja është iniciativë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbështetur edhe nga rezoluta nr.2803(2025), e datës 17.11.2025, e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektakti, në këtë fazë, nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Bërja palë në këtë Kartë, që themelon Bordin e Pagues, do të shoqërohet me efekte financiare për Republikën e Shqipërisë, që do të derdhen në formën e kontributit vullnetar nga çdo shtet anëtar, shtete të tjera, organizata dhe burime të tjera, kosto këto që nuk janë parashikuar në këtë moment.

Kontributi vullnetar që do të derdhë Republika e Shqipërisë do t'i shtohet buxhetit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2026, në programin buxhetor 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, në llogarinë ekonomike 605 “Kuota ndërkombëtare”. Nga ana tjetër, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të parashikojë koston financiare të këtij projektakti si pjesë e kërkesave buxhetore të saj, në kuadër të përgatitjes së PBA 2027-2029.

KËSHILLI I MINISTRAVE